



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0936

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare duke vendosur sipas ankesës së OE “CAPITAL X FET” SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale” me numër të prokurimit 632-25-7299-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E GJAKOVËS”, më 27/11/2025, mori këtë:

Vendim

- 1. Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e “CAPITAL X FET” SH.P.K. me nr. 2025/0936, e datës 21/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale”, me numër të prokurimit 632-25-7299-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E GJAKOVËS”.
- 2. Mbetet në fuqi** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale”, me numër të prokurimit 632-25-7299-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E GJAKOVËS”, i lejohet AK të vazhdojë me procedurë.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.08.2025, “KOMUNA E GJAKOVËS” , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale” me nr.prokurimi: 632-25-7299-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontrates: shërbim, vlera e parashikuar e kontrates: 180,000 €

Me 09.09.2025, OE “CAPITAL X FET” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 11.09.2025, Autoriteti Kontraktues e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 21.09.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “CAPITAL X FET” SH.P.K me nr. 2025/0936 lidhur me aktivitetin “Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale” me numër të prokurimit: 632-25-7299-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “CAPITAL X FET” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Me datën 04.09.2025 përmes e-prokurimi kemi kërkuar sqarime lidhur me pretendimet tona se në FDT , Specifikime Teknike dhe Ankesën 7 të makinerisë , por deri më datën 09.09.2025 kur ne kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim AK nuk na ka kthyer përgjigje në kërkesën tonë për sqarime , vetëm pasi ne kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim me pas AK na ka kthyer Sqarimet duke kaluar afati e parapare me LPP për kthim të përgjigjeve në Sqarime .

AK në kthimin e përgjigjes për Rishqyrtim ne aprovon si Pjesërisht të bazuar , por prap AK në dosjes të tenderit ndryshon dhe lene Kriteret Diskriminuese .

Pretendimi i parë , AK në FDT ka kërkuar : 1.Eksperti i Menaxhimit të Emergjencave me certifikim nga MPMS , kjo llogaritet si kërkesë diskriminuese nga që eksperti në fjalë nuk ruan ndonjë rol në ekzekutim të projektit për veqe që llogaritet si kriter diskriminues dhe është vendosur vetëm për aspektin administrativ . për këtë qeshtë ne kemi kërkuar përmes Sqarimeve si vijon por që AK nuk na është përgjigjur : Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka një ekspert të Menaxhimit të Emergjencave, minimum 5 vite përvojë pune. Të jetë i certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë nga MPMS. Pyetja jone është A duhet të llogaritet paga edhe këtij eksperti , nëse PO sa do të jete paga, nëse JO atëherë llogaritet si kërkesë diskriminuese nga që është kërkesë Administrative dhe jo për nevojën të ekzekutimit të projektit ?

Përgjigja e AK : Eksperti për menaxhim të emergjencave duhet të përfshihet brenda stafit.

AK ne kthim te pergjigjes citon se Eksperti për menaxhim të emergjencave duhet të përfshihet brenda stafit , por ne kete rast bie ndesh me kerkesen tjeret te dosjese ku kerkohet : Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME , Numri i punëtorëve që do të angazhohen me këtë kontratë do të jetë 20 punëtorë (njëzet) , AK nuk kerkon qe asnje punetore te jete i trajnuar per Siguri dhe Shendet ne Pune, si ka mundesi AK te kerkoje te angazhoje Eksperti për menaxhim të emergjencave i çertifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë nga MPMS , ndersa 20 punëtorë (njëzet) punëtorë asnjeri mos te jete i trajnuar

Prandaj edhe nje here konstatojme se Eksperti për menaxhim të emergjencave i çertifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë nga MPMS eshte Kerkese Diskriminuese nga qe eshte eshte kerkuar vetem per aspktin Administrative dhe per nevoja te Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve dhe jo per nevoja te egzekutimit te projektit ndryshe edhe stafi ne kete rast eshte dasht te kerkohet i trajnuar per siguri dhe shendet ne pune .

Pretendimi i dyte , AK ka kerkaur : 2. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. Ne Aneksin 7 keni kerkuar : Kamion me korp me gjatesi 35m per pastrimin e dritarev dhe fasadav te jashtme Kjo kerkese eshte diskriminuese dhe bie ndesh me LPP , Kuvendi Komunal Gjakoves ka perdhesen dhe dy kate qe ne total nuk arrihet lartesia 10 m, ne si OE kemi pasure me pare kontraten e njejte dhe pastrimin e gjamve e kemi bere me kamion me korpe afreisht 10 m , prandaj nuk eshte e nevojshme per kerkesat tuaj qe kamioni te jete 35 m fiks . Makine për larjen dhe terjen e dysHEMEVE (me akumlator ose me rryme) 10 cope Kerkese diskriminues dhe e pa nevojshme per egzekutimi te projektit nga qe objekti nuk ka nevoje dhe shumica e hapsirave jane pa pllaka por me tepihe .

Pergjigja e AK : Kamioni me korpë me gjatësi 35 metra ndryshohet në 25 metra, ndërsa makina për larjen dhe terjen e dysHEMEVE (qoftë me bateri apo me rrymë) nga 10 copë ndryshohet në 5 copë.

AK ka ndryshuar vetem gjatesin e korpes nga 35 metra fiks ne 25 metra fiks , qe eshte kerkese diskriminuese dhe favorizuese , ne ne parashtrimin e kerkese per rishyrtim AK i kemi cituar: Kuvendi Komunal i Gjakoves ka perdhesen dhe dy kate qe ne total nuk arrihet lartesia 10 , prandaj AK eshte dasht ta ndryshoje dhe te kerkoje Kamioni me korpë me gjatësi DERI 25 metra , dhe jo siq ka kerkuar 25 metra fiks , duke paraqitur Kerkese diskriminuese dhe duke ulur konkurrence per shkak qe janë te rralle Kamionet me korpe me gjatesi fiks 25m’ dhe realisht nuk nevoitet per egezekutim te projektit.

AK ka ndryshuar makina për larjen dhe terjen e dysHEMEVE (qoftë me bateri apo me rrymë) nga 10 copë ndryshohet në 5 copë , por qe edhe ketu ka eshte kerkese diskriminuese dhe favorizuese , per faktin qe edhe e kemi cekur ne Kerkese per Rishyrtim se : Kerkese diskriminues dhe e pa nevojshme per egzekutimi te projektit nga qe objekti nuk ka nevoje dhe shumica e hapsirave jane pa pllaka por me tepihe prandaj edhe 5 cope nuk duhen fare per egezekutim te projektit .

AK me daten 11.09.2025 na ka kthyer pergjigjen mbi Kerkesen tone per Rishqyrtim :

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHPsë. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Ne anen tjere daten e hapjese se tenderit e ka lene pikerisht daten : 22.09.2025 dite e hene e cila daten realishte eshte data e fundit per parashtrimin e Ankese ne OSHP , per shakak qe dita e 10 i bie te jete

vikend dite e diele , ndryshe AK nuk ka respektuar Afatet ligjore ne Keshillen Jurdike te Vendimit te Kerkese mbi Rishyrtim11.09.2025 Dita 012.09.2025 Dita 113.09.2025 Dita 214.09.2025 Dita 315.09.2025 Dita 416.09.2025 Dita 517.09.2025 Dita 618.09.2025 Dita 719.09.2025 Dita 8 20.09.2025 Dita 9 21.09.2025 Dita 10 (Ditë e Diele) 22.09.2025 Dita 10 (Ditë e Henë)

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur. Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë

“Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”.

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u çekën më lartë rezulton se autoriteti kontraktues nuk e ka përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka pasur parasysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që “Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.

Pra AK-ja me kërkesat që i çekëm më lartë dhe me përshkrimet që u çekën në këtë ankesë, e ka kufizuar konkurrencën në mesin e operatorëve ekonomik dhe ka përcaktuar kritere kufizuese/favorizuese.

Me kriteret, kërkesat dhe përshkrimet që AK-ja i ka përcaktuar, ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 26.4 të RRUOPP sepse aty ceket qartë që “Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuaam më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi të operatorëve ekonomik të ri, por i është kufizuar konkurrenca edhe operatorëve ekonomik me përvojë dhe me stabilitet ekonomik financiar dhe me aftësi teknike profesionale, prandaj duhet ndryshuar/larguar këto kërkesa që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “CAPITAL X FET” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1 i LPP-së, Neni 7 i LPP-së, Neni 27 i LPP-së, Neni 69 i LPP-së, Neni 18.9 i RRUOPP-së, Neni 26.4 i RRUOPP-së. Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr: VENDIM të APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE NDRYSHOHEN kërkesat, që u çekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim: Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakoves, rre datë 11.09.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë pjesërisht të bazuara. Sqarojmë se këto pika Autoriteti kontraktues i ka përmirësuar/ sqaruar me dt.09.09.2025, të sqarimet shtesë, si vijon:

1.Eksperti për mcnaxhim të emergjencave duhet të përfshihet brenda stafit.

2.Kamioni me korpë me gjatësi 35 metra ndryshohet në 25 metra, ndërsa makina për larjen dhe terjen e dysHEMEVE (qoftë me bateri apo me rrymë) nga 10 copëndryshohet në 5 copë.

3.Menaxheri për mbikëqyrjen e punës gjithashtu duhet të përfshihet brenda stafit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 23.09.2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0936/2025, ndërsa me datë 03.10.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/0936 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK në pajtim me dispozitat e nenit 7 dhe 51 të LPP të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, AK nuk ka dhënë përgjigje ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “CAPITAL X FET” SH.P.K ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0936 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1 Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 919/25 ka të bëjë me kërkesën e AK-së që Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka një ekspert të Menaxhimit të Emergjencave, minimum 5 vite përvojë pune. Të jetë i çertifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë nga MPMS.OE ankues ndër të tjera pretendon se “...Eksperti i Menaxhimit të Emergjencave me certifikim nga MPMS , kjo llogaritet si kerkese diskriminuese nga qe eksperi ne fjale nuk ruan ndonje role ne egzekutim te projektit per veqe qe llogaritet si kriter diksrimunes dhe eshte vendosur vetem per aspektin adminstrative”.

Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues, kërkesa për një ekspert për menaxhimin e emergjencave është jo relevante me këtë aktivitet të prokurimit “Mirëmbajtja higjienike”.Për më tepër, kompania për mirëmbajtjen higjienike (pastrim) në asnjë rrethanë nuk është as e autorizuar apo kompetente për menaxhim të çfarëdo rrethane emergjente, dhe detyrë e vetme e OE është mirëmbajtja higjienike (pastrimi) i hapësirave të komunës.Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar, dhe rekomandojmë të hiqet kjo kërkesë në tërësi, ndërsa AK eventualisht mund të kërkoj nga OE-të një punëtor të certifikuar për shëndet dhe siguri në punë.

Pretendiminr.2OE ankues pretendon se kërkesa e AK-së që OE të kenë kamion me korpë 35 metra e cila pastaj është zvgoluar në 25 metra, është kërkesë diskriminuese pasi sipas OE ankues “...Kuvendi Komunal i Gjakoves ka perdhesen dhe dy kate qe ne total nuk arrihet lartesia 10 m, ne si OE kemi pasure me pare kontraten e njejte dhe pastrimin e gjamve e kemi bere me kamion me korpe afërisht 10 m”.Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues, kërkesa e AK-së për kamion me korpë 25 metra është jo proporcionale me natyrën dhe nevojat e AK-së, nëse asnjë nga objektet që të bëhet mirëmbajtja nuk e arrin lartësinë 25 metra”.Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe rekomandojmë që kjo kërkesë të korrigjohet sipas nevojave reale të AK-së në terren.

Pretendimi nr.3OE pretendon se kërkesa e AK-së për makina për larjen dhe terjen e dysHEMEVE (qoftë me bateri apo me rrymë) nga 10 copë e ndryshuar në 5 copë, pasi sipas OE është Kerkese diskriminues dhe e pa nevojshme për ekzekutimi te projektit nga qe objekti nuk ka nevojë dhe shumica e hapësirave janë pa pllaka por me tepihë prandaj edhe 5 cope nuk duhen fare për egezkutim te projektit.Sipas mendimit të ekspertit OE nuk ka arritur të dëshmoj se kjo kërkesë e AK-së është panevojshme , andaj vlerësojmë se kjo kërkesë mund të qëndroj në dosje të tenderit, sidomos kur është e mundur që këto pajisje te merren me qera.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit

dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/saj, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Ankuesi pretendon se kërkesa e parashtruar nga AK që *Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka një ekspert të Menaxhimit të Emergjencave, minimum 5 vite përvojë pune. Të jetë i çertifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë nga MPMS.OE ankues ndër të tjera pretendon se "...Eksperti i Menaxhimit të Emergjencave me certifikim nga MPMS* duke pretenduar se kjo kërkesë është kërkesë diskriminuese pasi sipas OE ankues ekspert i kerkuar ne fjale nuk luan ndonje rol në ekzekutim të projektit dhe qe eshte vendosur vetem per aspektin administrative". PSH lidhur me kete pretendim ankimor nuk ja fal besimin ekspertit per shkak AK nuk e ka bere te pamundur edhe arritjen e ndonje marreveshje me nje ekspert te fushes se caktuar.

Ankuesi po ashtu pretendon se kërkesa e AK-së që *OE të kenë kamion me korpë 35 metra e cila pastaj është zvogeluar në 25 metra, është kërkesë diskriminuese pasi sipas OE ankues "...Kuvendi Komunal i Gjakoves ka perdhesen dhe dy kate qe ne total nuk arrihet lartesia 10 m,* po ashtu OE ankues deklaroi se *"si OE kemi pasur me pare kontraten e njejte dhe pastrimin e xhamave e kemi bere me kamion me korpe afërisht 10 m".*PSH kete pretendim ankimor e konstaton si pjesërisht e bazuar ngase kërkesa per kamion me korpe me lartesi 25 m., lartesia e korpes prej 25 m. mund te konsiderohet me permasa te medha mirepo sic eshte vertetuar edhe ne kete rast gjate procedures AK ka bere permiresimet e nevojshme ku nga kërkesa per kamioni me korpe me lartesi 35m ka bere permiresimet ne kamion me korpe ne 25 m. lartesi.

Ankuesi lidhur me pretendimin e trete ankimor pretendon se kërkesa e AK-së për *makina për larjen dhe terjen e dysHEMEVE (qoftë me bateri apo me rrymë) nga 10 copë e ndryshuar në 5 copë, pasi sipas OE është Kërkesë diskriminues dhe e pa nevojshme për ekzekutimi te projektit nga qe objekti nuk ka nevojë dhe shumica e hapësirave janë pa pllaka por me tepihë prandaj edhe 5 cope nuk duhen fare për egezkutim te projektit. PSH lidhur me kete pretendim akimor ia fal besimin pergjigjes se dhene nga eksperti shqyrtues perveq faktit se AK nga bere permiresimet e nevojshme dhe nga numeri i kerkuar 10 makina per larjen dhe terjen e dysHEMEVE i ka pergjysmuar ne 5 copë.,* me çka konstatohet se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale" me nr. të prokurimit: 632-25-7299-2-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale" me nr. të prokurimit: 632-25-7299-2-1-1, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rrjedhimisht paneli shqyrtues konstaton qe ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për

ofertim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - CAPITAL X FET SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: